VENDIM
Nr. 68, datë 4.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 28.4.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 17 (D) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Diana Kademi, Sutë Kademi, përfaqësuar nga avokati Hysni Beti, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë–Veri, përfaqësuar nga drejtori Ergyst Skënderi.

AVOKATURA E SHTETIT, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2512 (80-2017-2536), datë 6.6.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1312 (86-2024-1437), datë 15.7.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-968, datë 3.3.2025, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 23, pikat 1 e 2, 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; neni 71 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueseve Diana Kademi dhe Sutë Kademi *(kërkueset)*, të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Vendore Tiranë-Veri *(ASHK),* që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në datën 2.2.2017 dy kërkueset kanë ngritur padi në gjykatë, me objekt detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive *(ZVRPP)* për t'i dhënë kopje të dokumentacionit të dy pasurive të paluajtshme (truall dhe banesë), si dhe pajisjen e tyre me kartelat e pronësisë dhe të hartave treguese të tyre. Ato kanë pretenduar se janë pronare të dy pasurive, të cilat i kanë fituar me trashëgimi ligjore nga gjyshërit dhe se, në kundërshtim me ligjin, nuk

pajiseshin me aktet e pronësisë. Gjithashtu, ato kanë pretenduar se prej vitit 2008 i janë drejtuar vazhdimisht ZVRPP-së, për regjistrimin e dy pasurive në emër të tyre, por kanë marrë përgjigjen se ato figuronin të regjistruara në emër të personave të tjerë.

2. Konkretisht, në vitin 2010 kërkuesja Diana Kademi ka aplikuar për regjistrimin fillestar të pasurive, duke paraqitur edhe planin e rilevimit, por ZVRPP-ja i është përgjigjur se sipërfaqja ishte regjistruar në emër të shtetit dhe disa shtetasve të tjerë, ndaj ajo duhej të paraqiste skicë të vjetër të pozicionimit të pronës, ose t'u drejtohej organeve kompetente për saktësimin e saj. Në vijim, kjo kërkuese ka kërkuar nga ZVRPP-ja vënien në dispozicion të dokumentacionit të mënyrës sesi pasuritë ishin regjistruar në emër të shtetasve të tjerë. ZVRPP-ja e ka sqaruar se nuk dispononte të dhëna për një pjesë të pasurive të kërkuara, ndërsa për të tjerat i ka vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës, sipas regjistrimeve ekzistuese.

3. Në vitin 2016 kërkuesja Diana Kademi i ka kërkuar ZVRPP-së ta pajiste me certifikatat e pronësisë për dy pasuritë e trashëguara, por kërkesa nuk është pranuar, me argumentin se ajo nuk kishte paraqitur dokumentet tekniko-ligjore të pronësisë dhe se gjendja e pronave kishte ndryshuar, tashmë aty ishte ndërtuar një pallat, i cili, së bashku me truallin, ishte regjistruar në pronësi të një shoqërie ndërtimi. Gjithashtu, ZVRPP-ja i është përgjigjur se pasuritë në fjalë nuk i ishin nënshtruar procesit të regjistrimit fillestar, ndaj nuk kishte dokument hartografik për pozicionimin e tyre në hartën treguese digjitale të pasurisë.

4. Po në vitin 2016 kërkuesja Diana Kademi ka kërkuar nga ZVRPP-ja informacion për procedurat e aktet për kalimin e pasurive subjekteve të tjera, si dhe pajisjen me kopje të hartës treguese e kartelës së pasurive. Kësaj kërkese ZVRPP-ja i është përgjigjur duke dërguar aktet e fitimit të pronësisë dhe të dhënat e regjistrit hipotekar të viteve 1939 dhe 1942. Me pretendimin se përgjigjja ishte e paplotë, pasi nuk shpjegonte se përse nuk ishte pajisur me kartelat e pasurisë dhe me hartat treguese të tyre, kërkueset kanë paraqitur ankesa pranë Avokatit të Popullit dhe Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa në vitin 2017 i janë drejtuar gjykatës *(shih paragrafin 1 të këtij vendimi)*.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2512 (80-2017-2536), datë 6.6.2017, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se: i. ZVRPP-ja kishte paraqitur në gjykim aktet dhe dokumentet që pasqyronin ndryshimet në sipërfaqen dhe të drejtat e pronësisë për të dyja pasuritë, ndaj kërkimi për vënien në dispozicion të akteve të regjistrimit të pasurive në emër të personave të tjerë ishte realizuar; ii. pretendimet e kërkueseve për titujt e pronësisë të personave të tretë ishin rrëzuar në një proces tjetër gjyqësor, me vendim të formës së prerë, ndaj kërkimi që ZVRPP-ja t'i pajiste me kartelën dhe hartën treguese të pasurisë ishte i pabazuar. Ndonëse kërkueset kanë paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 1312 (86-2024-1437), datë 15.7.2024, me të njëjtin arsyetim.

6. Kërkueset kanë paraqitur rekurs, i cili është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 21.8.2024. Në rekurs ato kanë pretenduar, ndër të tjera, se vendimet e gjykatave të faktit binin ndesh me provat e administruara gjatë gjykimit, legjislacionin në fuqi, qëndrimet njësuese të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë e jurisprudencën kushtetuese, ligjin për të drejtën e informimit dhe të drejtën e pronës. Po sipas tyre, vendimet ishin kontradiktore dhe alogjike, ndërkohë që gjykata e apelit nuk u kishte dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura prej tyre në parashtrimet e datës 13.6.2024, në cenim të së drejtës së aksesit. Pas kryerjes së veprimeve administrative, dosja së bashku me rekursin janë përcjellë në Gjykatën e Lartë dhe çështja është regjistruar për shqyrtim në datën 7.11.2024.

7. Në datën 24.2.2025 kërkueset kanë depozituar në Gjykatën e Lartë shtesë rekursi, në të cilën kanë parashtruar, ndër të tjera, se arsyetimi i gjykatës së apelit binte ndesh me vendimin njësues nr. 00-2018-216, datë 13.2.2018, *(vendimi nr. 216/2018)* të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-968, datë 3.3.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkueseve, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(Ligji për Gjykatat Administrative)*.

9. Në datën 3.7.2025 kërkueset, nëpërmjet shërbimit postar, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pas plotësimit sipas kërkesave të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 18.7.2025.

10. Në datën 22.10.2025 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, në datën 24.10.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, kurse në datën 21.4.2026 ka vendosur pranimin e dorëheqjes së një gjyqtari kushtetues.

11. Me ligjin nr. 111/2018, datë 7.2.2019, "Për Kadastrën", kompetencat e ZRPP-së i kanë kaluar ASHK-së. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës në të cilën janë kryer veprimet.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. *Kërkueset,* në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

12.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

12.1.1. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi vendimi i gjykatës së apelit bie ndesh me vendimin njësues nr. 216/2018, sipas të cilit ZVRPP-të kryejnë veprime në regjistrat e pasurive vetëm për subjektet që rezultojnë në regjistër dhe mbi bazën e një akti administrativ, ose vendimi gjyqësor të formës së prerë.

12.1.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimit për mënyrën e fitimit dhe të regjistrimit të pronave në emër të personave të tretë. Ato kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme për të dyja pasuritë, ndërkohë që duhej të arsyetonin më vete për secilën prej tyre. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se pretendimet për pronën e trashëguar ishin rrëzuar me vendim gjyqësor të formës së prerë është i pabazuar, pasi procesi i mëparshëm kishte si objekt zgjidhjen e pasojave të regjistrimit të kontratës së dhurimit dhe jo pavlefshmërinë e saj. Gjykata e apelit nuk ka arsyetuar për parashtrimet e depozituara në datën 13.6.2024. Ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për pretendimet e parashtruara në shtesën e rekursit dhe për vendimin nr. 1698, datë 12.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (të depozituar me shtesën e rekursit), që tregonte se ishte vendosur pushimi i gjykimit për njohjen e pronësisë së shtetasve të tjerë mbi truallin.

12.2. *E drejta e informimit,* e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë anashkaluar faktin se në procesin administrativ barra e provës i takon organit administrativ. Në gjykim ato nuk kanë pretenduar mosdhënien e informacionit nga ZVRPP-ja, por informacioni i dhënë ka qenë i paplotë, pasi nuk informonte për mënyrën ose subjektet të cilave u kishin kaluar pasuritë dhe veprimet përkatëse. Edhe në prapësimet e paraqitura në gjykimin kushtetues, ASHK-ja nuk ka vënë në dispozicion praktikën e bashkimit të të dyja pasurive të trashëgimlënësve të tyre, kopje të fletëve të regjistrit hipotekar ku janë pasqyruar transkripti i pasurive, data e regjistrimit të tyre, kartelat dhe hartat treguese; aktin e fitimit të pronësisë së truallit nga shtetasit e tjerë; vërtetimin e pronësisë, mbi bazën e të cilit është lidhur kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë ndërtuese; vërtetimin e pronësisë së kësaj shoqërie për regjistrimin e pasurive objekt gjykimi në emër të saj. Dokumentet e depozituara

nga ASHK-ja nuk kanë lidhje me çështjen dhe nuk identifikojnë pasuritë për të cilat është kërkuar informacioni.

12.3. *E drejta e pronës,* pasi edhe pse që prej vitit 2008 i janë drejtuar ZVRPP-së për t'i pajisur me vërtetim pronësie për pronat e gjyshërve dhe për kalimin e tyre te trashëgimtarët, ZVRPP-ja ua ka mohuar këtë të drejtë. Qëndrimet e këtij organi për pasuritë në fjalë e dokumentacionin, mbi bazën e të cilit prona u ka kaluar personave të tjerë, kanë qenë të ndryshme. Regjistrimi i pasurive në emër të palëve të treta është kryer në mungesë të dokumentacionit të plotë ligjor e në kundërshtim me rregullat procedurale të ZVRPP-së. Gjykatat nuk kanë përcaktuar vendimet gjyqësore të formës së prerë për kalimin e pasurive në emër të shtetasve të tjerë e aktet përkatëse të ZVRPP-së për regjistrimin e pasurive në emër të tyre, pronarin e truallit dhe bazën ligjore të regjistrimit dhe datën e kalimit të pronësisë te shoqëria ndërtuese. Kartela e pasurisë e paraqitur në gjykim nuk plotëson kushtet ligjore për të shërbyer si provë për vërtetimin e pronësisë dhe vendimi gjyqësor për njohjen e faktit të pronësisë i vitit 1995 bie ndesh me nenin 41, pika 2, të Kushtetutës dhe me nenin 193, shkronja "dh", të Kodit Civil. Gjykatat kanë interpretuar vendimet gjyqësore për kontratën e dhurimit si akte të fitimit të pronësisë, ndërkohë që gjyshërit e tyre nuk kanë qenë palë në këto procese dhe nuk kanë shprehur vullnetin për tjetërsimin e pasurive të tyre.

13. ***Subjekti i interesuar, ASHK-ja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

13.1. Pretendimet për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë haptazi të pabazuara, pasi vendimet e kundërshtuara janë të arsyetuara.

13.2. Pretendimet për cenimin e *së drejtës së informimit* nuk qëndrojnë, pasi kërkueset kanë qenë në dijeni të plotë të faktit se në emër të kujt ka kaluar pasuria. Në kundërshtim nga sa pretendohet, ASHK-ja ka depozituar dokumentacionet dhe kartelat e pasurisë së paluajtshme dhe kërkueset kanë qenë në dijeni e janë pajisur me dokumentet objekt gjykimi.

13.3. Pretendimet për cenimin e *së drejtës së pronës*, për shkak të pavlefshmërisë së titullit të pronësisë, kanë rezultuar të pabazuara me vendim gjyqësor të formës së prerë. Vendimet gjyqësore, veprimi juridik për kalimin e pronës në emër të shtetasve të tjerë, kartela e pasurisë e mëparshme dhe ajo e rifreskuar janë paraqitur si prova në gjykim. Këto akte provojnë se pasuria është regjistruar në emër të shoqërisë ndërtuese, e cila, me dhënien e lejes së ndërtimit, ka ndërtuar mbi të një objekt shumëkatësh. Aktualisht pasuria rezulton në emër të personave të tretë, të cilët e kanë fituar mbi bazën e titujve të ligjshëm të pronësisë.

14. ***Subjekt i interesuar, Avokatura e Shtetit*****,** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueseve

15. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

16. Gjykata vëren se, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, kërkueset legjitimohen *ratione personae,* pasi kanë qenë palë në procesin

gjyqësor të kundërshtuar, ndaj justifikojnë interesin në çështjen e parashtruar. Po kështu, ato plotësojnë edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit, për rrjedhojë nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

17. Kërkueset në ankimin kushtetues individual kanë ngritur pretendimet për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor (*në aspektet e *parimit të sigurisë juridike* dhe *të standardit të arsyetimit të vendimit), së drejtës së informimit* dhe *së drejtës së pronës*. Për këto pretendime ato legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 3.3.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 3.7.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

18. Gjykata konstaton se pas kalimit të çështjes në seancë plenare (24.10.2025), kërkueset kanë depozituar parashtrimet e datës 9.4.2026, në të cilat kanë ngritur edhe pretendimin për cenimin e së drejtës së *aksesit efektiv*, me argumentin se gjykatat e zakonshme kanë përdorur vendimin civil për titullin e pronësisë si pengesë për dhënien e informacionit, duke u hequr mundësinë atyre për të provuar tjetërsimin arbitrar të pasurive të trashëguara. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se, në mbështetje të nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të saj dhe nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), shkaqet e ankimit kushtetues individual mund të ndryshohen (të shtohen ose të pakësohen), deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare *(shih vendimet nr. 28, datë 11.4.2024; nr. 63, datë 20.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit efektiv nuk mund të merret në shqyrtim, pasi është paraqitur pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

19. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkueset kanë pretenduar, ndër të tjera, cenimin e *së drejtës së informimit*, të garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, duke parashtruar se ZVRPP-ja nuk i ka dhënë informacion të plotë, por informacion kontradiktor lidhur me pasuritë e tyre, ndërsa gjykatat e zakonshme nuk e kanë riparuar këtë cenim, por janë shprehur se gjatë gjykimit kërkueset janë njohur me të gjitha aktet, ndërsa kanë anashkaluar faktin se në gjykimin administrativ barra e provës i takonte organit administrativ, pra ZVRPP-së. Subjekti i interesuar, ASHK-ja, ka prapësuar se nuk qëndron ky pretendim, pasi kërkueset kanë qenë në dijeni të plotë të faktit se në emër të kujt ka kaluar pasuria. Në kundërshtim nga sa pretendohet, ASHK-ja ka depozituar dokumentacionet dhe kartelat e pasurisë së paluajtshme dhe kërkueset kanë qenë në dijeni e janë pajisur me dokumentet objekt gjykimi.

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e informimit, e garantuar nga neni 23 i Kushtetutës, përfshin të drejtën e individit, që në përputhje me ligjin, të aksesojë fakte dhe të dhëna që lidhen me ushtrimin e pushtetit publik, në mënyrë që individi i informuar të ketë mundësinë të marrë pjesë në jetën publike. Në thelb, njohja e individit me informacion e ndihmon atë të formojë pikëpamje për gjendjen e shtetit e të shoqërisë, ndërsa autoritetet publike i nxit në drejtim të integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë *(shih vendimin nr. 7, datë 20.2.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, Gjykata çmon se argumentet e kërkueseve nuk mbrohen nga neni 23 i Kushtetutës, por kanë të bëjnë, në thelb, me të drejtën e procesit të rregullt ligjor, konkretisht me arsyetimin e gjykatave të zakonshme, të cilat kanë pohuar se kërkueset janë njohur me të gjitha aktet e regjistrimit të të dyja pronave të tyre.

21. Lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, kërkueset kanë parashtruar gjithashtu, në thelb, se gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tyre për mënyrën e fitimit të pronësisë dhe regjistrimit të pasurive në emër të personave të tretë, nuk kanë vlerësuar siç duhet provat dhe aktet mbi të cilat pasuritë u kanë kaluar këtyre personave, kanë

njohur të drejtën e tyre të pronës përmes gjykimeve në të cilat trashëgimlënësit e tyre nuk kanë qenë të pranishëm. Për të njëjtat shkaqe, sipas tyre, gjykatat e zakonshme u kanë cenuar edhe *të drejtën e pronës*. Subjekti i interesuar, ASHK-ja, i ka prapësuar si të pabazuara këto pretendime, me argumentin se, në kundërshtim nga sa kërkueset pretendojnë, ato kanë marrë përgjigje të arsyetuara nga gjykatat e zakonshme për pretendimet e tyre për të drejtën e pronës dhe konkretisht se këto pretendime kishin rezultuar të pabazuara me vendim gjyqësor të formës së prerë.

22. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përcaktimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit *(shih vendimet nr. 85, datë 23.12.2025; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata ka theksuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë *(shih vendimet nr. 11, datë 11.2.2026; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

23. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata vëren se kërkueset kanë vënë në lëvizje gjykatat administrative, duke ngritur pretendime për veprimtarinë administrative të ZVRPP-së. Në përgjigje të pretendimeve të tyre, gjykatat e zakonshme kanë konstatuar se aktet e regjistrimit të pasurive janë paraqitur në gjykim nga ZVRPP-ja, duke realizuar në këtë mënyrë njohjen e kërkueseve me to. Po kështu, gjykatat administrative kanë vlerësuar se kërkimi për t'u pajisur me certifikatë pronësie dhe hartat treguese, në thelb, kishte të bënte me njohjen e së drejtës së pronësisë, por titulli i pronësisë për të dyja pasuritë kishte qenë objekt i një procesi gjyqësor civil të përfunduar me vendim të formës së prerë. Në vlerësimin e Gjykatës, qëndrimi i gjykatave të zakonshme nuk rezulton me gabime të dukshme në drejtim të përcaktimit të fakteve ose të ligjit të zbatueshëm. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimet e kërkueseve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së pronës janë haptazi të pabazuara.

24. Kërkueset kanë pretenduar gjithashtu se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar *standardin e arsyetimit*, duke parashtruar se pretendimet e tyre të paraqitura në shtesën e rekursit nuk kanë marrë përgjigje. Konkretisht, bëhej fjalë për pretendimin se vendimi i gjykatës së apelit binte ndesh me vendimin njësues nr. 216/2018 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, shkak për të cilin, sipas kërkueseve, atyre u është cenuar edhe *parimi i sigurisë juridike*. Duke mbajtur në konsideratë natyrën kushtetuese të këtyre pretendimeve, Gjykata çmon t'i analizojë ato në këndvështrim të *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të garantuar nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

25. Kërkueset kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar për pretendimet e parashtruara prej tyre në shtesën e rekursit, në të cilat kanë parashtruar, ndër të tjera, edhe se vendimi i gjykatës së apelit binte ndesh me vendimin njësues nr. 216/2018 të Kolegjit Administrativ të saj.

26. Subjekti i interesuar, ASHK-ja, ka prapësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, por pa dhënë ndonjë argument konkret.

27. E drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se arsyetimi i vendimeve është element

thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 19, datë 10.4.2025; 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar i vendimeve të mospranimit të rekursit, si rregull, nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit *(shih vendimet nr. 28, datë 10.3.2026; nr. 44, datë 4.6.2024; nr. 10, datë 7.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

28. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se arsyetimi ka për funksion t'u tregojë palëve se janë dëgjuar nga gjykata, ka pohuar se Gjykata e Lartë duhet të ketë kujdes të shtuar në administrimin e të gjitha akteve të depozituara nga palët, përfshirë edhe shtesën e rekursit *(shih vendimin nr. 5, datë 29.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*. Kur shqyrtimi i rekursit bëhet nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve, paraqitja e shtesës së rekursit duhet evidentuar në vendimin e saj, edhe nëse në përfundim konkludon se ky akt është paraqitur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi *(shih vendimin nr. 30, datë 18.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese)*. Mungesa e arsyetimit në vendim për shkaqet me natyrë kushtetuese të ngritura në shtesën e rekursit vë në dyshim të drejtën e kërkuesit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e tij *(shih vendimet nr. 77, datë 5.11.2024; nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*, duke sjellë, si pasojë, edhe cenimin e së drejtës së aksesit *(shih vendimin nr. 50, datë 25.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*. Megjithatë, në rastet kur në shtesën e rekursit nuk parashtrohen shkaqe të reja në raport me rekursin, mospasqyrimi i tyre në vendim nuk përbën shkelje kushtetuese, për sa kohë që kjo mangësi nuk ka ndikuar në thelbin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë *(shih vendimet nr. 5, datë 29.1.2025; nr. 88, datë 28.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

29. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata, në vijim, do të verifikojë nëse shtesa e rekursit e paraqitur nga kërkueset përmbante shkaqe të reja dhe nëse mungesa e evidentimit të saj në vendimin e Gjykatës së Lartë ka vënë në dyshim thelbin e vendimmarrjes së kësaj gjykate dhe funksionin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

30. Në parantezë, Gjykata vëren se neni 43 i Kushtetutës garanton të drejtën e çdo individi për të ankimuar një vendim gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe për çështje me rëndësi ose vlerë të vogël. Në funksion të kësaj të drejte, si dhe të parimit të sigurisë juridike *(shih vendimet nr. 23, datë 4.3.2026; nr. 27, datë 18.5.2023; nr. 9, datë 7.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese),* legjislacioni procedural ka parashikuar afate dhe kërkesa formale për ushtrimin e mjeteve të ankimit, mosrespektimi i të cilave sjell pasojën e mospranimit të tyre.

31. Kështu, në gjykimin administrativ, rekursi depozitohet në gjykatën e apelit brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit që kundërshtohet (nenet 443 dhe 446 të KPC-së, si dhe neni 60 i Ligjit për Gjykatat Administrative). Ndonëse ligji nuk parashikon shprehimisht të drejtën për paraqitjen e shtesave të rekursit, ai rregullon procedurën për ndreqjen e të metave të tij (neni 57 i Ligjit për Gjykatat Administrative) dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të njoftuar datën e shqyrtimit të rekursit të paktën 15 ditë përpara (neni 61 i po këtij ligji). Këto dispozita synojnë garantimin e zhvillimit të rregullt dhe efektiv të procesit gjyqësor, duke siguruar, nga njëra anë, që palët të kenë dijeni për aktet dhe pretendimet e paraqitura, me qëllim ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes, dhe, nga ana tjetër, që gjykata të disponojë kushtet e nevojshme për të shqyrtuar dhe për të vendosur në mënyrë të informuar për mosmarrëveshjen. Për rrjedhojë, Gjykata thekson se e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor nuk vendos detyrime vetëm mbi organet gjyqësore, por kërkon edhe nga individi të tregojë kujdesin e duhur në përmbushjen e detyrimeve procedurale që ligji i ngarkon.

32. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se në datën 21.8.2024 kërkueset kanë depozituar në Gjykatën Administrative të Apelit rekursin e tyre ndaj vendimeve të gjykatave të faktit, që kishin rrëzuar padinë e tyre. Ato kanë pretenduar se vendimet ishin marrë në kundërshtim me faktet, provat e legjislacionin në fuqi, si dhe me praktikën njësuese të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë e jurisprudencën kushtetuese, por pa specifikuar vendime konkrete. Pas pothuajse 6 muajve, konkretisht më 24.2.2025, kërkueset kanë depozituar në Gjykatën e Lartë shtesë rekursi, në të cilën janë shprehur se po detajonin shkaqet e rekursit. Në shtesën e rekursit ato kanë parashtruar se vendimet gjyqësore nuk kishin respektuar vendimin nr. 216/2018, i cili, sipas tyre, përbënte qëndrim njësues të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

33. Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit dhe ka administruar aktet e çështjes, përfshirë rekursin dhe shtesën e tij. Në përfundim, ajo ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk përmbushnin kërkesat e nenit 58 të Ligjit për Gjykatat Administrative.

34. Në analizë të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se në arsyetimin e saj nuk evidentohet paraqitja e shtesës së rekursit dhe vlerësimi i saj, e cila *prima facie* përbën shkelje procedurale. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, nga pikëpamja kushtetuese, përveçse kur shkelja është thelbësore *(shih vendimet nr. 8, datë 10.4.2025; nr. 30 datë 18.4.2024; nr. 9, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese)*. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata do të analizojë nëse mosparaqitja e shtesës së rekursit në vendimin e Gjykatës së Lartë ka ndikuar ose jo në thelbin e së drejtës për të pasur një vendim të arsyetuar, pra nëse vendimi i Gjykatës së Lartë e ka përmbushur ose jo funksionin e tij për t'u treguar kërkueseve se janë dëgjuar për pretendimet e tyre.

35. Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se argumentet e parashtruara në shtesën e rekursit janë, në thelb, përsëritje e pretendimeve të ngritura më parë gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme dhe në rekurs. Edhe vetë kërkueset pohojnë në shtesën e rekursit se po detajonin shkaqet e rekursit. Lidhur me shkakun e mosrespektimit nga gjykata e apelit të vendimit nr. 216/2018 të Kolegjit Administrativ, ai jo vetëm që përbën konkretizim të shkakut të paraqitur në rekurs, me përmbajtje "vendimet e kundërshtuara janë marrë në kundërshtim me praktikën njësuese të Gjykatës së Lartë", por nuk përbën formalisht as vendim njësues. Vendimi nr. 216/2018 është marrë nga një trup gjykues i përbërë nga 5 gjyqtarë, bazuar në parashikimet e nenit 12, pika 3, të Ligjit për Gjykatat Administrative dhe nuk ka vendosur njësimin e praktikës gjyqësore, shkak për të cilin Gjykata e Lartë nuk ka urdhëruar të botohej në Fletoren Zyrtare. Në kushtet kur ky vendim nuk është njësues, Gjykata çmon se nuk qëndron pretendimi i kërkueseve për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*.

36. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se në pjesën arsyetuese të Gjykatës së Lartë, është paraqitur teksti i plotë i nenit 58 të Ligjit për Gjykatat Administrative, shkronja "b" e të cilit parashikon si shkak rekursi mosrespektimin e vendimeve njësuese. Mbi këtë bazë ligjore, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ishte detyrë e kërkueseve t'i parashtronin shkaqet qartësisht dhe t'i argumentonin pretendimet për zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural ose rëndësinë themelore të shkeljes në kuadër të njësimit ose zhvillimit të praktikës gjyqësore. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë duket se e ka vlerësuar çështjen edhe në raport me respektimin nga gjykatat e faktit të vendimeve njësuese, ndaj kërkueset kanë marrë përgjigje për të.

37. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se mospasqyrimi në vendimin e Gjykatës së Lartë i pretendimeve të parashtruara në shtesën e rekursit nuk ka ndikuar në thelbin e vendimmarrjes së saj. Në këtë mënyrë, ajo nuk përbën shkelje thelbësore, ndaj pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa, sipas arsyetimit të mësipërm, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 4.6.2026.
Shpallur më 11.6.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini